



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1057

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga zv.Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahimimi – Kryesuse, isa Hasani dhe Vedat Poterqoi-Anëtar të Panelit, duke vendosur sipas ankesës së OE “Gurëbardhi” SH.P.K., kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit ” Ndertimi i rruges Bajram Bahtiri Faza e II-te Ritender ” me numër të prokurimit: 616-24-10457-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, më 31/01/2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e “Gurëbardhi” SH.P.K.”, me nr. 2024/1057, e datës 28/10/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndertimi i rruges Bajram Bahtiri Faza e II-te Ritender” me numër të prokurimit: 616-24-10457-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna e Prishtinës”, ndërsa AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmara lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
3. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 04.10.2024, Komuna e Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndertimi i rruges Bajram Bahtiri Faza e II-te Ritender” me numër të prokurimit 616-24-10457-5-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë, vlera e parashikuar e kontratës: 2,900,000.00 €.

Me 22.10.2024, OE “Gurëbardhi” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 23.10.2024, Autoriteti Kontraktues e ka miratuar si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 28.10.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Gurëbardhi” SH.P.K.”, me nr. 2024/1057 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndertimi i rruges Bajram Bahtiri Faza e II-te Ritender” me numër të prokurimit 616-24-10457-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Gurëbardhi” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i pare (I) : A.K edhe pse është Procedur Ritenderimi , që ka rezultuar në mungesë të O.E . të përgjegjshëm në Heren e pare, konsiderojm se Kriteret ishin diskriminuese ku A.K. nuk ka treguar integritet dhe përgjegjësi në Qëllimin e A.K. në realizim të këtij projekti. Ku me këto Pretendime se nuk janë respektuar pikat 1.2 dhe 3 të Nenit 1 të LPP.

Pretendimi i dytë (II) : Konsiderojm se në Përgaditje të Kriterëve -Kërkesave A.K. ka shkelur Pikat 1.2.3 dhe 4 të Nenit 7 dhe konsiderojm se nuk ka trajtuar njesoj dhe duke përdorur kriteret favorizuese për diktë e diskriminuese për të tjeret , nuk ka respektuar nenin 7 Barazi në trajtim ,Jo diskriminim.

Pretendimi i tretë (III) : Zyrtaret e prokurimit me vetedije nuk kanë respektuar nenin 24 , përkatesisht pikën dhe 2 . NENI 28 Specifikimet teknike 1. Autoriteti kontraktues do të parashtronte të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues (i) do të parashtronte specifikimet e tilla në njoftimin në fjalë, ose (ii) do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike. Kurdo që është e mundur këto specifikime teknike duhet të definohen në atë mënyrë sa që të merren parasysh kriteret për mundësinë e qasjes së personave me aftësi të kufizuara apo dizajnimin për të gjithë shfrytëzuesit. 2. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë

operatorë ekonomik. 3. Specifikimet teknike do të formulohen ose duke iu referuar standardit të aplikueshëm, specifikimit, miratimit apo referencës teknike që kërkohet sipas paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni ose si një alternative lidhur me kërkesat e ekzekutuese ose funksionale, duke përfshirë karakteristikat mjedisore sipas paragrafit 9. të këtij neni. Autoriteti kontraktues mund të zgjedhë që të përdorë standardet ose specifikimet tjera sipas paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni për karakteristika të caktuara dhe kërkesat e ekzekutuese ose funksionale për karakteristika tjera. 4. Autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian. (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim. 5. Nëse një standard i aplikueshëm, specifikim, ose miratim që kërkohet nga sipas paragrafit 4. nuk ekziston, ose nëse përdorimi i tij kërkon që autoriteti kontraktues të përdorë materiale ose produkte që nuk janë të përshtatshme me pajisjet që tashmë janë në dispozicion ose nëse përdorimi i tyre do të shkaktonte shpenzime të tepruara dhe të panevojshme, autoriteti i tillë kontraktues mund të përgatisë specifikacionin e tillë teknik duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës ose (ii) një miratimi teknik të Kosovës. 6. Nëse një tenderues mund të paraqet në tenderin e tij, përmes çfarëdo mase të duhur (siç janë, dosjet teknike ose raport testimi nga një palë e tretë e pavarur), se zgjidhja e propozuar nga tenderuesi në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesat e definuara në specifikim teknik, autoriteti kontraktues nuk mund të refuzoj tenderin me arsyetimin se produkti ose shërbimi i ofruar nuk përputhet me specifikimet teknike të formuluar duke iu referuar ndonjë specifikimi të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni. 7. Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenjë dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët “ose ekuivalent” 8. Kërkesat ekzekutuese dhe funksionale duhet të jenë të sakta në mënyrë që të iu mundësoj tenderuesve që të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës dhe ti lejoj autoritetet kontraktuese që të shpërblejnë kontratën. Standardet apo specifikimet e tjera të paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni mund të përdoren si një mjet i ruajtjes së përputhshmërisë me kërkesat ekzekutuese apo funksionale. 9. Kur autoriteti kontraktues e ka parashtruar specifikimin teknik për kërkesat ekzekutuese ose funksionale, ai nuk mund të përdorë kërkesat e tilla si arsyetim për refuzimin e tenderit, produktit ose shërbimit që është në përputhshmëri me një specifikim të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni nëse specifikimi i tillë trajton kërkesat e njëjta ekzekutuese ose funksionale dhe është i përshtatshëm. Tenderuesi duhet të paraqesë në tenderin e tij, në mënyrën më të përshtatshme (siç është ajo e dosjeve teknike ose raportit të testimit nga një palë e tretë e pavarur), që produkti ose shërbimi, janë në përputhshmëri me specifikimet e lartpërmendura gjithashtu i plotëson kërkesat ekzekutuese ose funksionale të autoritetit kontraktues. 10. Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara.

Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet të bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Pretendimi katërt (IV) : A.K. ne Njoftimin per kontrat dhe dosjte tenderit Ka perdorur kriteret favorizuese ne Piken 69 te Kerkesave qe do ti anazizojm nje nga nje ne Vijim KERKESAT Kriteri pika 7 7) OE duhet te dëshmoj se ka autorizuar një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Infrastrukturë Rrugore (jo bachelor) , kërkohet te ketë min. 8 vite përvojë pune pas diplomimit, DESHMI NE KERKESAT PIKEN 7 Për pikën 7) të bashkëngjitet edhe Certifikaten përkatëse për FIDIC Për pikën 10) Operatori Ekonomik, duhet të ofroj dëshmi CV-ja (Original e nënshkruar); Qertifikata ISO 9001 2015 nga trajnimi përkatës, Kontrata e punës me ofertuesin.

Pretendimi i peste (V) : Kriteri qe Inxhinjeri te kete 8 vite pervoj pune pas diplomimit eshte Diskriminues then ndryshe pergaditje per dike . LPP mund te kerkoj pervoje pune ne projekte te caktuara ne numer te projekteve apo vlera te tyre meq vitet nuk percaktojne cilesi nese nuk kane te percjellur projektete ngjashme , Si do te veprohej nese X inxhinieri ka 7 vite pervoj pune ne Realizim te projekteve me vlera milioneshe e ai me 8 vite ka vetem nje projekt me nje vlere minimale si do percaktohej Vlera e X inxhinieri .Andaj Kerkojm qe Pervoja e punes te Kerkohej me Vlera dhe numer te projekteve e jo me vite Kerkesat Nen piken c Njoftimin per Kontrate - Paisjet 5) Eskavator me peshe minimum 73.5 ton --- 1 Copë 7) Miningarkues (bobcat ose i ngjashëm), me peshë minimum 4.1 ton 1 Copë 8) Miningarkues (bobcat ose i ngjashëm), me peshë minimum 3.7 ton 1 Copë 12) Cilinder për ngjeshje të zhavorit me dhëmbëza minimum 1 tonë deri maksimum 1.5 tonë. 1 Copë 15) Paisje (nivelizues) për rregullim dhe nivelizim të zhavorit për bankina... 1 Copë DESHMIT E KERKUARA NE PIKEN C C).Të dorëzohet lista e pajisjeve – mjeteve te punës të nevojshme për realizim te projektit dhe te deshmohej me; Deklaratat doganore, faturat, librezat e qarkullimit. Vërejtje Vëmendje ! Në rast se O.E. nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshje për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësi.

Pretendimi i gjashtë (VI) : Pretentohet se nuk kane nevoj per peshat e cekura kur jane minimal dhe fikse e paisja nen numer rendor 5 as qe ka nevojje ne kete projekt meq nuk ka pozicion trotuari . 1.Paisje Eskavatori Pse 73.5 ton 2.Miningarkuesi me pesh minimum 3.7 ton 3.Miningarkues minimum 3.7 ton 4.Cilinder per ngjeshje te zhavorit me dhemeza minimum 1 ton deri .1.5 ton 5 Paisje nivelizues per rregullimin dhe nivelizimin te zhavorit per bankina.

Pretendimi i shtate (VII) : Konsiderojm se A/K. Ka bere shkelje kur tek paisjet Perkatësisht Dronet ka percaktuar Tipat e Droneve gje qe ka Shkelur Nenit e Paisjeve apo programe Bred Name, KERKESAT NEN PIKEN 25) PAISJE GJEODEZIKE Dron Advanced F) Operatori duhet të posedojë bazë të asfaltit ose të ketë marrëveshje për furnizim me asfalt me ndonjë kompani që posedon bazë për prodhimin e asfaltit . Baza duhet të jetë e pajisur me seperator të

vajrave.Engine me dual gimbal opsione per dy kamera kompatibil me kamere standard per aerofotogrametri dhe opsion per SLAM LIDAR 3D SCANER SYSTEM, me 55 min max fluturim, me sensor 6 drejtimesh, me kamere . + Software per postprocesim, barazim, orientim te mbrendshëm dhe projektim të aero-imazheve të dronit dhe sinjalit PPK RTK për post-barazim të rrugës së fluturimit për përpunim të mëtuqjeshëm të ortofotos dhe modelit 3D 1 Copë 26) PAISJE GJEODEZIKE Sistem LIDAR 3D Skaner Multifunksional me 4 opsione Hany Station, Mobile-Vehicle Station, GNSS RTK Station dhe UAV Drones Station, per mundesi kombinimi Simulant i lokalizimit dhe MapimitSLAM për përdorim me DRON dhe montim mbi veturë me HDR Kamere Panaromike dhe Mobile Software. + Mobile Software SLAM Manager për procesim dhe përpunim të mëtuqjeshëm të skanimit të terrenit dhe modelit 3D LIDAR SYSTEM 1 Copë DESHMI TE KERKESAT NEN PIKEN 25 DHE 26 C).Të dorëzohet lista e pajisjeve – mjeteve te punës të nevojshme për realizim te projektit dhe te deshmohe me; Deklaratat doganore, faturat, librezat e qarkullimit. Vërejtje Vëmendje ! Në rast se O.E. nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshje për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësi.

Pretendimi i tete (VIII) : Kërkesa per paisjen Seperator te vajrave , Nuk eshte e nevojshme pasi Seperacioni ka paisjet per kryerje te te gjitha puneve ne pergaditje dhe shtrim te asfaltit , ku edhe eshte e licencuar e ne veqanti kjo Pisje e quajtur Seperator te vajrave , Tregu i studiur ne Kosove vetem nje O.E posedon . Bile nuk ka ne treg ne regjion asper blerje. Andaj eshte paisje e kurdisur per O.E . qe ka ne Kosove . KERKESA TE PIKA F) Operatori duhet të posedojë bazë të asfaltit ose të ketë marrëveshje për furnizim me asfalt me ndonjë kompani që posedon bazë për prodhimin e asfaltit . Baza duhet të jetë e pajisur me seperator të vajrave. DESHMI TE KERKESAVE TE PIKA F F) Kopja e licences lejes per aktivitete te veqanta të vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e OE. Marreveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit.. Të dëshmohet pajisja e seperatorit të vajrave me DUD, apo faturë.(kopje e noterizuar nga origjinali), Pretendimet ne Shkeljet e pretenduara jane te specifikuara si shkelje edhe ne interpretim ne Rregulloren e prokurimit publik nr.01/2023 , dhe Udhezuesit nr.01/2023 Shënim: Informatat obligative të kërkuara gjatë kompletimit të Dosjes së Tenderit dhe të specifikuara në tabelën më lartë janë të përfshira edhe ne RrPP, por të cilat janë përsëritur edhe në këtë udhëzues në mënyrë që AK-se të udhëzohen t'i kenë parasyshë gjatë përgaditjes së Dosjes së Tenderit, gjithmonë duke shmangur përgaditjen e DT në një mënyrë që favorizon ose diskriminon një ose më shumë Operatorë Ekonomik potencial.

Përgjigje e Autortitetit Kontraktues ndaj kërkesës per rishqyrtim:

Operatori ekonomik "Gurebardhi" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 22.10.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës Bajram Bahtiri Faza II - Ritender" me nr. të prokurimit

616-24-10457-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (in meritum) të kërkesës.

P.1. - Parashtruesi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesën nr. 7 në DT të formuluar si vijon "OE duhet të dëshmoj se ka autorizuar një inxhinier të diplomuar ose master Drejtimi Infrastrukturë Rrugore (jo bachelor), kërkohet të ketë min. 8 vite përvojë pune pas diplomimit, i çertifikuar me Fidic - angazhime profesionale". Parashtruesi ka pretenduar se 8 vite përvojë të punës nuk dëshmojnë kapacitet profesional të inxhinierit. Po ashtu ka argumentuar se çertifikata Pidic nuk garanton cilësi nëse nuk ka përvojë të ngjashme të punës.

P.2. - Parashtruesi ka kundërshtuar kërkesë e AK për pajisjet si vijon "eskavator me peshë min. 73.5 ton (1 copë); miningarkues (bobcat ose i ngjashëm) me peshë min. 4.1 ton (1 copë); miningarkues (bobcat ose i ngjashëm) me peshë min. 3.7 ton (1 copë); cilindër për ngjeshje të zhavorit me dhëmëza min. 1 ton deri maksimum 1.5 ton (1 copë); pajisje (nivelizues) përrregullim dhe nivelizim të zhavorit për bankina (1 copë)". Parashtruesi pretendon se pajisjet duhet të largohen sepse kanë peshafikse.

P.3. - Parashtruesi e kundërshton kërkesën e DT për dron për matje gjeodezike me pretendimin se është përcaktuar lloji i dronit.

P.4. - Parashtruesi e kundërshton kërkesën e DT për bazë të asfaltit si dhe kërkesën për pajisjen për seperator të vajrave me pretendimin se ato nukjanë të nevojshme për realizim të kontratës.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 1, fillimisht duhet sqaruar se projekti në fjalë është mjaft kompleks mirëpo mjaft i rëndësishëm për infrastrukturën rrugore të kryeqytetit. Pavarësisht kesaj qëllimi i AK është që të stimuloj konkurrencën me rastin e ofertimit prandaj ka përcaktuar në dosjen e tenderit vetëm ato kërkesa që janë absolutisht të domosdoshme për realizimin me sukses të këtij projekti. Sa i përket kërkesës për inxhinier të infrastrukturës rrugore, vlen të theksohet fakti që është kërkuar vetëm një inxhinier i tillë pavarësisht faktit që projekti ka të bëjë me ndërtimin e rrugës përkatëse. Mirëpo duke qenë se në një projekt për ndërtimin e rrugës, AK ka vendosur që të kërkoj vetëm një inxhinier për infrastrukturë rrugore, dhe më e pakta që ka mundur të kërkohet është që i njëjti të ketë minimalisht 8 vite të përvojës së punës. Vlen të thuhet se zakonisht për projekte të natyrës së tillë kërkohen 2 apo më shumë inxhinier ku njëri

prej tyre duhet të ketë së paku 10 vite përvojë të punës. Mirëpo në rastin konkret është kërkuar që inxhinieri për infrastrukturë rrugore të ketë minimalisht 8 vite përvojë të punës. Duke marrë parasysh përgjegjësinë dhe kompleksitetin e projektit por edhe faktin që është vetëm një inxhinier për infrastrukturë rrugore, i njëjti domosdoshmërisht duhet të dëshmoj 8 vite përvojë të punës.

Sa i përket kërkesës për çertifikatë Fidic vlen të thuhet se kjo kërkesë nuk është e domosdoshme pasi që çertifikata e tillë i referohet menaxhimit të kontratës. Përderisa kjo kërkesë është përcaktuar për një inxhinier tjetër, atëherë AK do të ndryshoj kërkesën përkatëse ashtu që do të largoj pjesën e çertifikatës Fidic nga kërkesa për inxhinier të infrastrukturës rrugore. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi ankimor nr. 1 I parashtruesit është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 2, fillimisht duhet sqaruar se për asnjërën nga pajisjet e kërkuara në DT nuk është kërkuar peshë fikse. Përkundrazi maksimumi i peshës nuk është përcaktuar fare për shumicën e tyre dhe për disa pajisje tjera nuk është përcaktuar fare pesha. Për një pjesë tjetër të pajisjeve është përcaktuar edhe minimum dhe maksimumi mirëpo për asnjërën pajisje nuk është përcaktuar pesha fikse. Sa i përket pajisjeve të cilave ju referohet pretendimi ankimor i parashtruesi, konkretisht për eskavatorin dhe për miningarkuesit është përcaktuar pesha minimale që patjetër duhet të kenë këto pajisje. P.Sh. është kërkuar miningarkues 4.1 tonë mirëpo nëse parashtruesi e posedon miningarkuesin me peshë më të madhe si p.sh 5.2 ton ose 4.7 ton, atëherë këto do pranohen nga AK. Pra në asnjë rast nuk është përcaktuar peshë fikse për asnjë pajisje por është përcaktuar ose minimumi, ose maksimumi, ose minimumi dhe maksimumi ose nuk është përcaktuar pesha fare. Rrjedhimisht në këtë kontekst pretendimi ankimor I parashtruesit sipas të cilit pajisjet kanë peshë fikse është pretendim i pabazuar në tërësi.

Megjithëse nuk është kontestuar fare nga parashtruesi nevoja për këto pajisje por vetëm pesha e tyre, vlen të thuhet se të gjitha këto pajisje janë absolutisht të domosdoshme për të realizuar një projekt mjaft kompleks sikurse ndërtimi i rr. Bajram Bahtiri faza II.

P.sh. eskavatori 73.5 ton është pajisje e domosdoshme për të realizuar me sukses dhe brenda afatit të arsyeshëm poz. 3.1/Rruga (Gërmimi i dheut i kategorisë IIIZIV dhe V me ngarkim) sipas paramasës (Ekziston një sasi jashtëzakonisht e madhe e dheut që duhet gërmuar dhe ngarkuar dhe për shkak të fortësisë së dheut që është në kategorinë e V, që dmth se me asnjë eskavator tjetër më të vogël nuk do të mund të realizohet me sukses dhe/ apo brenda afatit pozicionet përkatëse të paramasës).

Tutje, miningarkuesit janë po ashtu pajisje të domosdoshme për të realizuar pozicionet 2.Rruga (Ngarkimi i asfaltit të demoluar, kubzave dhe betonave) dhe 2.3/Rruga (Ngarkimi i shkalleve dhe mureve prej betonarme pasi të demolohen) sipas paramasës. Po ashtu janë të domosdoshëm për të realizuar edhe poz. 2.2/Ujësjiellësi (Mbulimi i kanalit me rere 0-4) dhe 2.3/Ujësjiellësi (Mbulimi i kanalit me rere 0-16). Tutje miningarkuesit janë të domosdoshëm për të realizuar edhe poz. 1.1 Kanalizimi atmosferik (Mbulimi i gypave me rere 0-4) si dhe poz. 1.15 Kanalizimi atmosferik (Mbulimi i kanalit me material 0-60). Vlen të shtohet po ashtu se miningarkuesit përdoren edhe për arsye se rruga është me qarkullim shumë të madh, dhe këto pajisje përdoren

për të kryer punë në hapësirë mjaft të ngushtë, për shkak të mundësisë së rrotullimit në hapësirë të vogël.

Cilindri me dhëmbëza nga 1 deri 1.5 ton është pajisje e domosdoshme për të realizuar poz. 1.15/Kanalizimi fekal (Ngjeshja e mbushjes nga materiali gur i thyer 0-60 mm cdo 20-30 cm). Cilindri më i madh se 1.5 ton nuk mund të përdoret në kanalet me gjerësinë kaq të ngushtë sikurse ato që janë përcaktuar sipas paramasës ndërsa cilindrat më të vogël se 1 ton (nëse ka të tillë) nuk mjaftojnë për të realizuar me sukses punimet pa shkaktuar vonesa të paarsyeshme apo dëme eventuale gjatë realizimit. Nivelizuesi i zhavorit për bankina është pajisje e domosdoshme për të realizuar poz. 3.8/Rruga (shtrirja e zhavorit për bankina). Pra kjo pajisje është e destinuar për të realizuar këtë pozicion dhe si e tillë është po ashtu e domosdoshme për projektin. Nga sa u tha më sipër, të gjitha pajisjet e përcaktuara sipas DT duke përfshirë edhe ato që janë përmendur në pretendimin ankimor të parashtruesit janë pajisje absolutisht të domosdoshme për të realizuar me sukses pozicionet përkatëse të paramasës sikurse është elaboruar më sipër. Në mungesë të cilitdo prej këtyre pajisjeve do të rrezikoj që të dështonte i gjithë projekti pasi që nuk do të arrihej që brenda afatit të arsyeshëm sipas planit dinamik të realizohen pozicionet përkatëse të paramasës të sipërcituara. Prandaj nga cilido këndvështrim i mundshëm pretendimi i parashtruesit për pajisjet është i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 3, duhet sqaruar se parashtruesi nuk e konteston nevojën-domosdoshmërinë e këtyre pajisjeve për të realizuar me sukses projektin në fjalë. Pavarësisht se ky fakt është jokontestues, vlen të theksohet që dronët e kërkuar sipas DT janë të domosdoshëm për të realizuar pozicione vijuese të paramasës: Kategoria "Rruga"

Poz. 1.4 Inqizimi i gjendjes së terrenit me pajisje gjeodezike të avancuara-gjegjesisht me sistemin GPS, TOTAL dhe sistemin Lidar. Poz. 4.10 Verifikimi dhe evidentimi i sasive, kubaturave të sasive të realizuara me sisteme të avancuara gjegjesisht me GPS TOTAL dhe sistemin LIDAR. Kategoria "Kanalizimi fekal" Poz: 1.14 Matja gjeodezike e elementeve të rrjetit si dhe matja e gypit para mbulimit të kanalit në çdo lidhje mes dy gypave dhe në mes të gypit, të dhenat e matjeve duhet të pergaditen në formatin DWG dhe EXCEL dhe të dorëzohen në raporte javore tek KRUP-DPZH. Kategoria "Kanalizimi atmosferik" Poz 1.14 Matja gjeodezike e elementeve të rrjetit si dhe matja e gypit para mbulimit të kanalit në çdo lidhje mes dy gypave dhe në mes të gypit, të dhenat e matjeve duhet të pergaditen në formatin DWG dhe EXCEL dhe të dorëzohen në raporte javore tek KRUP-DPZH. Parashtruesi përmes pretendimit nr. 3 vetëm pretendon se është kërkuar një brend i caktuar i dronëve. Sipas kërkesës së DT janë kërkuar dy dronë përmes kërkesës nr. 25 dhe 26 të formuluar si në vijim PAISJE GJEODEZIKE: " Dron Advanced Engine me dual gimbal opsione për dy kamera kompatibel me kamere standard për aerofotogrametri dhe opsion për SLAM LIDAR 3D SCANNER SYSTEM, me 55 min maxfluturim, me sensor 6 drejtimesh, me kamere . + Softzware për post-procesim, barazim, orientim të mbrendshëm dhe projektim të aero-imazheve të dronit dhe sinjalit PPK RTK për post-barazim të rrugës së fluturimit përpëpunim të mëtutjeshëm të ortofotos dhe modelit 3D -1 Copë".

PAISJE GJEODEZIKE: "Sistem LIDAR 3D Skaner Multifunksional me 4 opsione-Hany Station, Mobile-Vehicle Station, GNSS RTK Station dhe UAV Drones Station, per mundesi kombinimi Simulant i lokalizimit dhe Mapimit-SLAM përpërdorim me DRON dhe montim mbi veturë me HDR Kamere Panaromike dhe Mobile Softivare. + Mobile Sofhvare SLAM Manager për procesim dhe përpunim të mëtutjeshëm të skanimit të terenit dhe modelit 3D LIDAR SYSTEM -1 Copë".

Ekzistojnë me qindra nëse jo me mijëra lloje të brendeve, markave dhe/ apo prodhuesve të ndryshëm të dronëve që përdoren për matje gjeodezike sot Asnjë nga këto brende nuk është përmendur në kërkesat e DT të formuluar si në vijim. Megjithatë secili prodhues apo brend serioz prodhon dronë gjeodezik me karakteristikat e përcaktuara përmes kërkesave të sipërcituara nga DT. Me fjalë të tjera, jo vetëm që nuk janë kërkuar drone nga brende/prodhues të caktuar sikurse ka pretenduar parashtruesi, por edhe specifikat e dronëve janë aq bazike dhe të thjeshta sa që ato përmbushen nga të gjitha brendet apo prodhuesit serioz të pajisjeve të tilla gjeodezike. Pra nga të gjitha këndvështrimet e mundshme pretendimi ankimor i parashtruesit është i pabazuar për faktin se në DT nuk është përcaktuar brendi i dronëve sikurse ka pretenduar parashtruesi (as marka, tipi apo prodhuesi). Në anën tjetër as vet parashtruesi nuk e konteston fakti se këto pajisje gjeodezike janë të domosdoshme për të realizuar pozicionet e cituara më sipër nga paramasa. Vlen të shtohet se parashtruesi vetëm ka pretenduar se në DT është përcaktuar brendi mirëpo nuk i ka kundërshtuar karakteristikat e dronëve nga DT si të tilla, Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 4, sa i përket bazës së asfaltit me seperator për vajra duhet cekur se kërkesa për bazë asfalti është absolutisht e domosdoshme sepse projekti ka të bëjë me asfaltim të rrugës. Pra është një nga parakushtet kryesore për realizimin e

një projekti të tillë. Në anën tjetër seperatori i vajrave e bën ndarjen e vajrave lidhur me bazën e asfaltit me qëllim të mbrojtjes së mjedist dhe shëndetit publik. Me fjalë të tjera kërkesa për bazë të asfaltit me seperator për vajra është absolutisht e domosdoshme për realizimin e projektit me sukses dhe duke mos dëmtuar ambientin dhe shëndetin publik.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht vetëm pretendimin nr. 1 ndërsa nuk ka paraqitur argumente për të mbështetur pretendimet tjera ankimore. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është miratuar vetëm si pjesërisht e bazuar.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 lidhur me nenin 62 të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 04/11/2024 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe

pretendimeve sipas ankesës me nr. 1057/2024, ndërsa me datë 29/11/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2024/1057 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, Autoriteti kontraktues është pajtuar rreth raportit të ekspertit shqyrtues/teknik. Ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje rreth raportit të ekspertit shqyrtues/teknik.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Gurëbardhi SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1057 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I) : Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës nr.1057/24 ka të bëjë me kërkesën e AK-së që inxhinieri i infrastrukturës rrugore të ketë minimum 8 vite përvojë pune.

OE ankues pretendon se kërkesa që inxhinieri të ketë 8 vite përvojë pune pas diplomimit “...është Diskriminues then ndryshe përgaditje për dike . LPP mund të kërkojë përvojë pune në projekte të caktuara në numër të projekteve apo vlera të tyre meqë vitet nuk përcaktojnë cilësi nëse nuk kanë të përcjellur projektet ngjashme , Si do të veprohej nëse X inxhinieri ka 7 vite përvojë pune në Realizim të projekteve me vlera milionesh e ai me 8 vite ka vetëm një projekt me një vlerë minimale si do të përcaktohej Vlera e X inxhinieri .Andaj Kërkojmë që Përvoja e punës të Kërkohej me Vlera dhe numër të projekteve e jo me vite .”

Pas analizimit të shkresave të lëndës, vendimit të AK-së në kërkesë për rishqyrtim dhe arsyetimit për vendosjen e kësaj kërkesë, eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa e përvojës prej 8 vite si e vetme, jo domosdoshmërisht dëshmon përvojën e inxhinierit në punë të ngjashme, njëkohësisht është diskriminuese për inxhinierin të cilët kanë diplomuar përpara 7 viteve mirëpo kanë përvojë të begatshme në punë të ngjashme me projekte konkrete.

Rekomandimi i ekspertit shqyrtues është që kërkesa për përvojën e inxhinierit të zvogëlohet në minimum 5 vite përvojë pune, duke shtuar si kërkesë që inxhinieri të ketë përvojë dhe dëshmi për ndonjë projekt/punë konkrete të ngjashme me një vlerë të caktuar të projektit. Në këtë

mënyrë vlerësojmë se do ti krijoheshin kushte për pjesëmarrje më të gjerë të operatorëve ekonomik, njëkohësisht duke ofruar dëshmi për kapacitetin/përvojën e inxhinierit. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Konstatimi i dytë (II): Pretendimi tjetër ankimorë është AK duke vendosur kërkesa për peshën e pajisjeve :

“Pretentohet se nuk kane nevoj për peshat e cekura kur jane minimal dhe fikse e paisja nen numer rendor 5 as qe ka nevoje ne kete projekt meq nuk ka pozicion trotuari .”.

AK në vendim ndaj kërkesës për rishqyrtim, ka potencuar se peshat e kërkuara nuk janë fikse, por janë kërkuar si pesha minimale të pajisjeve, duke arsyetuar po ashtu nevojën për peshën/kapacitetin punues të pajisjeve në krahasim me nevojat dhe punët konkrete që duhet të kryhen sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Në rastin konkret vlerësojmë se kërkesat e dosjes së tenderit sa i përket këtyre pajisjeve janë relevante dhe proporcionale me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Konstatimi i tretë (III) : OE ankues pretendon se :

“Konsiderojm se A/K. Ka bere shkelje kur tek paisjet Perkatesisht Dronet ka percaktuar Tipat e Droneve gje qe ka Shkelur Nenit e Paisjeve apo programe Bred Name.

AK në vendim ndaj kërkesës për rishqyrtim, sqaron se nuk janë kërkuar dron të ndonjë prodhuesi apo brend i caktuar, mirëpo është kërkuar teknologjia e nevojshme për skanim dhe matje siq janë LIDAR 3D etj, dhe këtë teknologji e ofrojnë shumë prodhues të ndryshëm të dronëve.

Pas analizimit të pretendimeve ankimore dhe përgjigjes së AK-së, e pas hulumtimeve tona të mëtutjeshme, kemi gjetur se ashtu siq pretendon AK-KK Prishtinë, teknologjia LIDAR 3D nuk është brand name, por është teknologji, por është term (shkurtim) i fjalëve Light Detection and Rangig (LIDAR)-Detektmi dhe Shtrirja/Matja e dritës).

Kjo teknologji (ashtu siq pretendon AK) ofrohet nga shumë prodhues të ndryshëm të dronëve, andaj kërkesa e AK-së vlerësojmë se nuk është as kufizuese e as favorizuese për ndonjë OE të caktuar.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Konstatimi i katërt (IV) : Pretendimi i fundit ankimorë ka të bëjë me kërkesën e AK-së që Operatori duhet të posedojë bazë të asfaltit ose të ketë marrëveshje për furnizim me asfalt me ndonjë kompani që posedon bazë për prodhimin e asfaltit . Baza duhet të jetë e pajisur me seperator të vajrave.

Sipas OE ankues :“Kerkesa për paisjen Seperator të vajrave , Nuk është e nevojshme pasi Seperacioni ka paisjet për kryerje të të gjitha punëve në përgatitje dhe shtrim të asfaltit , ku edhe është e licencuar e në veqanti kjo Pajisje e quajtur Seperator të vajrave , Tregu i studiuar në Kosovë vetëm një O.E posedon . Bile nuk ka në treg në regjion asfer blerje. Andaj është paisje e kurditur

per O.E . qe ka ne Kosove .” AK pretendon se kërkesa që baza e asfaltit të ketë separator të vajrave është bërë për qëllim të ruajtjes së ambientit.

Vlerësimi ekspertit është se kërkesat/kushtet e bazave të asfaltit përcaktohen nga institucionet tjera përkatëse para licencimit të këtyre bazave.

Andaj vlerësojmë se nuk është kompetencë as e OSHP-së e as e Autoriteve Kontraktuese përcaktimi i kriterëve shtese për pronartët e bazave të asfaltit përderisa të njëjtit janë licencuar për këto baza nga organet kompetente.

Sipas udhëzuesit të KPMM : “për baza të Asfaltit operatori që të operoj në mënyrë legale nga MMPH-ja duhet të pajiset me Pëlqim Mjedisor dhe Leje Mjedisore. Në të kundërtën operimi është ilegal.”.

Nga kjo që u cek më lar, vlerësojmë se autoritetet kontraktuese nuk mund të shtojnë kushte dhe kërkesa ne emër të ruajtës së mjedisit, përderisa kompanitë (bazat e asfaltit) kanë pëlqim mjedisor dhe leje mjedisore nga MMPH, anadaj rekomandojmë që kjo kërkesë të nga dosja e tenderit.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues/teknik i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues Argumentimi në raportin e ekspertës/teknike është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues/teknike mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertës shqyrtues/teknike. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit OSHP kërkon nga eksperti shqyrtues/ teknik që ti shqyrtojnë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105

të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndertimi i rruges Bajram Bahtiri Faza e II-te Ritender” me numër të prokurimit 616-24-10457-5-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues/teknike, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “Gurëbardhi” SH.P.K., aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndertimi i rruges Bajram Bahtiri Faza e II-te Ritender” me numër të prokurimit 616-24-10457-5-1-1, dhe AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim sipas rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/ teknik.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - GURËBARDHI SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: